

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, permdryshe shkruhet

1. Informacion i pergjithshem

Shoqëria TID sh.p.k., në vijim e quajtur Shoqëria, është themeluar ne date 03/12/1998 dhe eshte regjistruar me vendim nr. 20374, date 05/12/1998 te Gjykatës Tiranë nga ortakut i vetëm, Z.Behar Male.

Në datën 31 dhjetor 2022 kapitali i nenshkruar i shoqërisë TID sh.p.k. është 650,734,000 leke.

Ortakut i vetëm dhe Administrator i shoqërisë është Z. Behar Male.

Objekti kryesor i shoqërisë eshte Import-eksport, rieksporim, tranzitim, tregetim te te gjitha mallrave te ndryshem me shumice e pakice, produkte me origjin buqesore, blektorale, mallra te ndryshem ushqimor te gatshem e gjysem te gatshem, materiale ndertimi te llojeve te ndryshme, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare. Marrje persiper e hartimit te projekteve te ndryshme ndertimore te fushave te ndryshme dhe te realizimit te anes ndertimore te tyre. Investime ne fushen e turizmit, infrastrukture, konvertim te valutave, qiradhenes se zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme. Veprimtari ne fushen e estetikes dhe dermokozmetikës, hapja dhe mbajtja e qendrave me profil estetiken, dermo-kozmetikën, trajtimin e lekures dhe trupit, masazheri dhe mirembajtje trupore, fitness dhe pishina. Gjate vitit 2021 shoqeria ka filluar aktivitetin dhe ne fushen e tregtimit te energjise.

Adresa e Shoqerise eshte : "Abdi Toptani", ndertesa Torre Drin, ap. 121, kati 12, zona.

Shoqeria eshte e regjistruar si person juridik ne Degen e Tatimpaguesve te Medhenj me NIPT J82427007R.

Me 31 dhjetor 2022 shoqeria kishte 24 punonjes (31 dhjetor 2022; 86 punonjes)

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe pergatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, date 10/05/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit të përmirësuar.

(b) Parimet e pergatitjes

Pasqyrat financiare janë pergatitur mbi bazën e parimit te koston historike.

Monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë është Lekë.

(c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Drejtimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (regullime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

- Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, permdryshe shkruhet

- Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Drejtimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabel kryesore

Politikat kontabel të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet e kryera ne monedhe te huaj jane konvertuar ne Leke me kursin e dites se kryerjes se transaksionit, ndersa gjendet e llogarive te mjeteve dhe detyrimeve ne monedhe te huaj jane konvertuar ne Leke me kursin zyrtar ne ditën e fundit te vitit te shpallur nga Banka e Shqiperise. Diferencat nga kurset e kembimit paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, ne kohen kur ndodhin.

Kursi i shpallur nga Banka Shqiperise ne 31 dhjetor, sipas monedhave perkundrejt lekut:

Monedha	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR	114.23	120.76
USD	107.05	106.54

3.2. Aktivitet Afatgjata Materiale

AAM janë njohur në momentin kur shoqëria është bërë titullare ligjore e tyre ose ka kontrollin ekonomik mbi to, pret të marrë përfitimet në të ardhmen dhe kur mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Në njohjen fillestare aktivet vlerësohen me koston e sigurimit të tyre e cila përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve.

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitet ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Në bilanc paraqiten të vlerësuar me koston e amortizuar e cila rezulton si diferencë nga kostoja e tyre minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi i AAM të hyra gjatë vitit llogaritet në raport me kohën e hyrjes së tyre. Në rast rivlerësimi aktivet vlerësohen me koston e caktuar në raportin e ekspertit të vlerësimit. Amortizimi i AAM llogaritet në përputhje me normat e caktuara nga ligji nr. 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”. Amortizimi llogaritet me metoden e vlerës së mbetur, duke marrë për afërsisht jetëgjatësinë e këtyre aktiveve. Metodat dhe normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria paraqiten si me poshte:

	Norma Amortizimit %	Metoda Llogaritjes
Ndërtesa	5%	me vleften e mbetur
Makineri e pajisje	20	me vleften e mbetur
Mjete Transporti	20	me vleften e mbetur
Mobilje Orendi	20	me vleften e mbetur
Pajisje Informatike	25	me vleften e mbetur



Pasqyrat Financiare te Shoqërise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

3.3. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe te tjera, mjete monetare ne arke dhe ne banke, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Aktivët dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompesuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, parate ne arke, llogarite rrjedhese, depozitat me afat dhe garancite e vendosura ne bankat tregtare vendase. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Overdraftet bankare përfshihen nën zerin hua financiare, tek detyrimet afatshkurtra të bilancit.

Llogarite e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi (nese ka). Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë regjistruar me vlerën e drejtë, njohja e mëpasshme behet me kosto të amortizuar.

Huate e marra dhe te dhena

Huate financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte minus kostot e transaksionit, njohja e mepasshme behet me kosto te amortizuar, duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve diferencon midis kosos dhe vleres se pagueshme nominale gjate periudhes se huase, bazuar ne interesin efektiv.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiv.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

3.4. Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomiksht apo ligjërsh, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Në hyrje inventarët e materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Në bilanc inventaret paraqiten me vlerën me të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme e cila është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes. Shoqëria i ka vlerësuar inventaret gjendje në fund të vitit me kosto mesatare të ponderuar.

3.5. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Të ardhurat nga ndërtimi njihen në masën e kryerjes së punimeve mujore të kryera dhe situacionuara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

3.6. Përfitimet e punonjesve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kontributet për sigurime shoqërore ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur lind detyrimi për to.

3.7. Shpenzim i Tatimit mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Norma e aplikuar për Tatim fitimi për vitin 2022 është 15 % (2021; 15%).

Tatim fitimi për periudhën korrente dhe ai i papaguar për periudhat e mëparshme njihen si detyrim afatshkurter në bilanc. Në rastet kur tatim fitimi i paguar në periudhën korrente ose ato paraardhese kalon detyrimin e tatim fitimit, vlera e mbipaguar paraqitet në aktivet afatshkurtra.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	Ne 31 dhjetor 2022	Ne 31 dhjetor 2021
Mjete monetare në banke në leke	6,420,932	5,863,671
Mjete monetare në banke në monedha të tjera	222,107,271	31,287,949
Arka në leke	309,512	4,202,026
Arka në monedha të tjera	448,901	2,815,670
	229,286,615	44,169,316



Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

5. Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Kliente per shitje energjie	2,109,000,619	707,850,835
Kliente te tjere	310,333,769	368,677,978
Zhvlersim kliente	(58,882,963)	-
	<u>2,360,451,425</u>	<u>1,076,528,813</u>

6. Llogarite e arketueshme te tjera

Llogarite e arketueshme te tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Kerkesa nga te trete	6,186,888	21,305,039
TVSH proces gjyqesor	3,976,850	3,976,850
TVSH	562,371	22,732,013
Parapagime te dhena	-	489,609,460
	<u>10,726,109</u>	<u>537,623,362</u>

7. Inventare

Inventaret më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Produkt i Gatshem Ndertimi	51,662,969	67,906,847
Mallra	14,090,747	33,989,640
Inventar i imet ne perdorim	31,250	8,914,191
Materiale te para dhe ndihmese	-	3,351,327
	<u>65,784,966</u>	<u>114,162,006</u>

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, përndryshe shkruhet

8. Investime ne Pjesemarrje

Investimet ne pjesemarrje më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	%	Ne vlere	%	Ne vlere
The Plaza Tirana sha	45%	551,677,590	45%	500,680,625
Hydroborsh shpk	5%	7,005,000	5%	7,005,000
Infotelecom-Albsolar2 shpk	20%	5,000,020		
AMB Konstruktion shpk	20%	2,000,000		
HIDROBEGAJ shpk	5%	5,000		
Totali		565,687,610		507,685,625

Shoqëria ka zgjedhur metoden e kapitalit per njohjen e pjesës se saj të fitimit në pjesmarrjen që ka në shoqërinë "The Plaza Tirana" sh.a. Per vitin 2022, pjesa e fitimeve te shoqerise se njohur ne te ardhura nen zerin " Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet, te Pasqyra e Performances eshte 50,996,965 leke (2021: 91,945,584 leke).

Ky fitim për efekte fiskale sipas ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" konsiderohet e ardhur e patatueshme dhe është bërë rregullimi përkatës.(shiko shenimin 27).

9. Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata

Gjate vitit 2022, shoqeria ka investuar ne obligacione te emetuara nga Tirana Bank, ne shumen 50 mije euro, me afat maturimi 7 vjet dhe norme interesi vjetore 3.3%.

10. Tituj te tjere te huadhenies

Hua te dhena paleve te treta, më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Alb Shop	29,053,648	29,053,648
Soal	19,990,250	21,133,000
Ardi 2M	13,707,573	14,491,171
Kruja S	1,871,154	1,871,154
Ener Trade	-	333,297,600
Zhvleresim kerkesa	(29,053,648)	(29,053,648)
	35,568,977	370,792,925

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat në lekë, përmbryshe shkruhet

11. Aktivët Afatgjatë Materiale

Investimet dhe pakësimet në aktive afatgjatë materiale detajohen sipas klasave të AAM-ve në tabelën në vijim:

Kosto	Ndertesa	Instalime, makineri e pajisje	Mjete transporti	Paisje zyre	Paisje kompjuterike	Total
Gjendja 01.01.2022	3,218,255,731	157,815,132	27,667,950	43,530,250	7,507,253	3,454,776,316
Blerjet gjatë viti ushtrimor	14,407,817	116,667	-	564,950	480,808	15,570,242
Shitjet gjatë viti ushtrimor	(132,407,817)	(80,779,159)	(886,400)	(41,866,537)	(6,426,317)	(262,366,230)
Gjendja 31 dhjetor 2022	3,100,255,732	77,152,639	26,781,550	2,228,663	1,561,745	3,207,980,329
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja 01.01.2022	951,665,260	122,586,470	13,881,042	33,745,752	6,549,968	1,128,428,492
Amortizimi i periudhës ushtrimore	111,654,398	4,843,311	2,740,770	1,174,546	190,386	120,603,410
Amortizim i akumuluar pakësime	(39,939,127)	(58,316,561)	(781,192)	(33,767,541)	(5,857,371)	(138,661,792)
Gjendja 31 dhjetor 2022	1,023,380,530	69,113,220	15,840,619	1,152,757	882,983	1,110,370,109
Vlera neto me 31 dhjetor 2021	2,266,590,471	35,228,662	13,786,908	9,784,498	957,285	2,326,347,825
Vlera neto me 31 dhjetor 2022	2,076,875,202	8,039,419	10,940,931	1,075,906	678,762	2,097,610,220

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

12. Detyrime per institucionet e kredise

Huate aftashkurtra nga bankat më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Tirana Bank	655,078,063	722,680,956
OTP bank	114,489,903	-
Kesti ASH OTP Bank	68,538,000	72,456,000
Kesti ASH FI Bank	17,583,407	15,620,329
Abi Bank	5,903,887	59,977,140
	<u>861,593,260</u>	<u>870,734,425</u>

13. Arketime ne avance per porosi

Paradheniet e marra nga klientet më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Parapagime per punime	530,870	32,321,502
	<u>530,870</u>	<u>32,321,502</u>

14. Llogari te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Llogari e pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Furnitore per energji elektrike	488,654,058	351,294,226
Furnitore te tjere	311,958,214	321,608,592
Furnitore pale te lidhura	291,599	14,606,053
	<u>800,903,871</u>	<u>687,508,871</u>

15. Te pagueshme ne shoqeri brenda grupit

Llogari te pagueshme bredna grupit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
BM-HEALTHCARE shpk	1,679,522	-
	<u>1,679,522</u>	<u>-</u>

Ne vitin 2022, shoqeria ka themeluar me 100% te kapitalit shoqerine BM-HEALTHCARE shpk. Detyrimi i paraqitur, i perket humbjes mbi vleren e kapitalit te investuar, ne vijim te njohjes se rezultatit te periudhes me metoden e kapitalit. Humbja me vlere 5,321,022 leke perfshihet ne pasqyren e te ardhurave ne zerin “Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet”

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

16. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Tatim mbi fitimin	100,783,027	19,974,263
Sigurime shoqerore dhe Shendetstore	443,793	1,308,439
Tatim mbi te ardhurat personale	215,983	274,760
Tatim ne burim	72,985	19,500
Detyrime per taksa lokale	34,283	-
	<u><u>101,550,071</u></u>	<u><u>21,576,962</u></u>

17. Te tjera te pagueshme

Te tjera te pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Detyrime ndaj ortakut	86,379,270	21,198,650
Kreditore te tjere	272,591	2,432,539
	<u><u>86,651,861</u></u>	<u><u>23,631,189</u></u>

18. Tituj te huamarrjes afatgjate

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Hua nga Agna Sha	392,685,185	752,820,698
	<u><u>392,685,185</u></u>	<u><u>752,820,698</u></u>

Shumat e kreditimit dhe te interesave jane te ndryshueshme ne marrveshje midis paleve. Interesat e llogaritura per vitin 2022, jane 23.4 mil leke. (2021: 28.2 mil leke).

19. Hua afatgjate nga bankat

Hua afatgjate më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Hua OTP Bank	519,746,500	694,370,000
Hua FI Bank	88,365,657	125,440,562
Hua BKT	-	2,821,713
	<u><u>608,112,157</u></u>	<u><u>734,555,946</u></u>

Ne vitin 2021, shoqëria ka marre hua pranë Alpha Bank (bashkuar me perthithje ne vitin 2022 nga Banka OTP Albania). Detyrimi i mbetur ne 31 dhjetor 2022 eshte 5,150 mije euro. (2021: 5,750 mije euro). Kesti afatshkurter qe do te paguhet ne vitin 2023 eshte 600 mije euro (2022: 600 mije euro) dhe eshte paraqitur nen zërin e huave afatshkurtra.

Shoqeria ka marre hua prane bankes FI Bank vlere e mbetur e te ciles ne 31 dhjetor 2022 eshte 909 mije euro. (2021: 1039 mije euro). Kesti afatshkurter qe do te paguhet ne vitin 2023 eshte 136 mije euro. (2022: 129 mije euro) dhe eshte paraqitur nen zërin e huave afatshkurtra.

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

20. Kapitali i nenshkruar

Gjate vitit 2022, nuk ka ndryshime ne vleren e kapitalit te nenshkruar dhe ortaket e shoqerise.

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Kapitali i nenshkruar	650,734,000	650,734,000
Ortaket e shoqerise dhe perqindja e zoteruara ne kapital ne 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:		
	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Behar Male	100%	100%

21. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021</u>
Te ardhura nga shitje energji	9,969,356,139	2,900,675,731
Te ardhura nga qiraja	280,547,163	225,317,946
Shitje mallra e te tjera	121,346,705	47,798,531
Situacione punimesh	54,637,017	7,721,104
Te ardhura nga qendra Nobis	53,002,614	99,576,995
Shitje produkt i gatshem	11,589,186	9,294,616
Te ardhura te tjera	2,368,167	-
	<u><u>10,492,846,992</u></u>	<u><u>3,290,384,923</u></u>

22. Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Të tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021</u>
Fitime nga shitje AAM-ve	108,692,926	-
Sherbime marketingu	1,170,000	402,600
Te tjera	116,400	20,317
	<u><u>109,979,326</u></u>	<u><u>422,916</u></u>

Gjate vitit 2022, shoqeria ka shitur ambjentet dhe paisjet ku zhvillohej aktiviteti i qender Nobis, duke realizuar nje fitim ne vlere 108.67 mije leke.



Pasqyrat Financiare te Shoqerise
“Tirana International Development” Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

23. Materiale te para dhe te konsumueshme

Materiale te para dhe te konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Kosto e energjise se shitur	9,004,652,442	2,560,546,133
Kosto e mallrave	113,891,916	44,216,371
Kosto punime	45,332,828	-
Kosto produkteve	16,243,878	10,265,069
Materiale te para dhe te tjera te konsumueshme	16,446,751	15,867,316
Shpenzime utilitare	18,920,019	17,499,147
Mirembajtje dhe te tjera	20,430,919	5,909,798
Te tjera	1,311,061	377,014
	9,237,229,815	2,654,680,848

24. Shpenzime te tjera te shfrytezimit

Shpenzime te tjera te shfrytezimit, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Zhvleresim aktive financiare	58,882,963	29,053,648
Konsulenca te lidhura me energjine	15,643,925	-
Mirembajtje, riparime	19,576,125	7,067,143
Te tjera	11,412,462	4,164,262
Shpenzime qiraje	11,431,057	1,560,000
Tatime te tjera	9,744,476	4,838,228
Perfaqesimi	6,687,560	349,635
Komisione banke	4,788,009	23,368,375
Prime sigurimi	3,154,771	2,761,749
Taksa lokale	2,352,741	2,661,109
Komunikimi	792,089	846,818
Sherbime auditimi	530,000	400,000
Publicitet reklama	465,050	1,250,660
Gjoha penalitete	168,367	1,666,138
Sherbime nga te trete	100,955	4,939,719
Shpenzime rivleresimi	-	29,800,000
Vlera neto e AAM-ve	-	2,444,772
	145,730,551	117,172,255

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme

Shpenzime dhe te ardhura nga interesa, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime interesi per hua nga banka	29,137,362	61,820,691
Shpenzime interesi per hua nga banka te lidhura me energjine	84,038,307	21,594,197
Shpenzime interesi per hua te tjera	23,411,169	28,225,419
Te ardhura nga interesa per hua te dhena	(6,882,830)	(1,270,698)
Interesa kreditore	(88,378)	(48)
	<u>129,615,630</u>	<u>110,369,560</u>

26. Shpenzime te tjera financiare

Te ardhura te tjera financiare, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, detajohen si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021</u>
Humbje nga diferenca kursi	16,476,373	5,316,032
	<u>16,476,373</u>	<u>5,316,032</u>

27. Shpenzime Tatim mbi fitimin

Llogaritja e tatim fitimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021</u>
Fitimi para tatimit	956,172,770	299,188,812
Shpenzime te panjohura	78,754,506	78,275,643
Te ardhura te patatueshme	(45,675,943)	(91,945,584)
Rezultati tatimor	989,251,333	285,518,871
Humbje te mbartura	-	(87,165,834)
Tatim fitimi @15%	<u>148,387,700</u>	<u>29,752,956</u>

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
"Tirana International Development" Shpk
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shumat ne leke, perndryshe shkruhet

28. Pale te lidhura

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve ose detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pa konsideruar nëse mbahen ndalesa. Një palë e lidhur është një palë e cila kontrollon, është e kontrolluar nga ose është nën të njëjtin kontroll me, njësinë; ka një interes në njësi e cila jep ndikim domethënës mbi njësinë; ose ka kontroll mbi njësinë, është një ortak i njësisë; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësia është pjesëmarrëse; ose është pjesë e personelit kryesor të drejtimit të njësisë ose të shoqërisë mëmë (përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes të secilit prej individëve të referuar më sipër). Shoqëria ka pale te lidhura shoqërite dhe individët e paraqitur ne vijim:

Pala	Marredhenia
BM-HEALTHCARE shpk	Shoqeri grupi
The Plaza Tirana sha	Investime ne pjesemarrje
Infotelecom-Albsolar2 shpk	Investime ne pjesemarrje
AMB Konstruksion shpk	Investime ne pjesemarrje
Behar Male	Ortak

Balancat me palet e lidhura ne 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Te drejta nga palet e lidhura		
Ortak	24,919,407	-
Shoqeri grupi	50,000	-

Detyrime ndaj paleve te lidhura

Detyrime per shperndarje fitimi	86,379,270	21,198,650
Investime ne pjesemarrje	291,599	14,606,053

Transaksionet me palet e lidhura per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, paraqiten si me poshte:


	Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2021
Te ardhura		
Investime ne pjesemarrje	196,089,016	101,011,687
Ortak	23,584,016	-
Shoqeri grupi	50,000	-
Blerje		
Investime ne pjesemarrje	3,014,792	535,276
Ortak	1,560,000	-

9. Ngjarjet pas dates se raportimit

Juk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto asqyra financiare.

ADMINISTRATOR

Behar Male

Behar Male

**INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA**

Shefe e Finances

Arta Halili

Arta Halili
